

VENDIM
Nr. 127/2026

**PËR MOSZGJEDHJEN E NJË KANDIDATURE PËR ANËTAR TË KOMISIONIT
TË PROKURIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 25, pika 2, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Moszgjedhjen e zotit Julian Dhima anëtar të Komisionit të Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 23.7.2026.